



Çfarë thotë Ligji?

Diskutime mbi aspektet ligjore në Shqipëri!


#shkëndijat

Aspekte historike mbi shtetin dhe të drejtën

Demokracia Popullore




Demokracia e mandatuar



Pjesëmarrje në vendimarrje

- Konsultime
- Ankese
- Nisma
- Iniciativa
- Etj.





Legjislacioni është tërësia e normave shoqërore të shkruara që kanë një procedurë të mirëpërcaktuar miratimi dhe zbatimi.

Dispozita për Njoftim dhe Konsultim publik

- Ligji nr. 146/2014, “Për njoftim dhe konsultim publik”.
- Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Akte normative sektoriale.

AKTE TË DETYRUESHME PËR KONSULTIM

(Bazuar tek Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”)

Kur Këshilli i Bashkisë zgjedh nga përbërja e vet komisionet dhe miraton rregulloren e brendëshme të funksionimit të vet.

Kur Këshilli i Bashkisë miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.

Kur Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Kur Këshilli i Bashkisë vendos për taksat dhe tarifat vendore.

Kur Këshilli miraton norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Edhe cdo vendimarrje tjetër që konsiderohet nga KB si e rëndësishme për komunitetin duhet të konsultohet.

Dispozita të Veçanta për të Drejtën e Ankesës

Kushtetuta, Neni 48

- Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë **kërkesa, ankesa ose vërejtje** organeve publike, të cilat janë të **detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.**

Ligji nr. 44/2015, Kodi i procedurave Administrative (detaje procedurale).

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19:

- Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojë **kërkesa, ankesa apo vërejtje Këshillit Bashkiak** për çështje që lidhen **me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e Bashkisë.**
- **Këshillit Bashkiak është i detyruara të marrë në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejë përgjigje** brenda afateve të përcaktuara me ligj

<https://sites.google.com/vieë/keshillibashkiakrrogozhine/>

REGJISTRAT ELEKTRONIKË

Në këtë seksion do gjeni regjistrat elektronikë të këshillit bashkiak Rrogozhinë si dhe formularin e ankesave

REGJISTRI I ANKESAVE, KËRKESAVE DHE VËREJTJEVE

REGJISTRI I BRENDSHËM I PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE

REGJISTRI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

REGJISTRI I PROJEKT AKTEVE PER KONSULTIM PUBLIK, TE KESHILLIT BASHKIAK

FORMULAR I ANKESAVE, KËRKESAVE DHE VËREJTJEVE

Ankesa duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e ankuesit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet përgjigjia;
- c) përshkrimin e ankesës;
- ç) çfarë pret ankuesi nga Këshilli;
- d) çdo të dhënë apo dokument që ankuesi gjykon se mund të ndihmojë në shqyrtimin e ankesës.

Ankuesi në tekstin e ankesës specifikon nëse për çështjen për të cilën ka bërë ankesë ka hapur një proces gjygjësor apo jo.

#shkëndijat


Emër Mbiemër	Bashkia: _____ Njësia administrative: _____	Data: __/__/20__
	Adresa postare: _____	Nënshkrimi: _____
Z./Znj. _____	Adresa elektronike: _____	Mënyra e dorëzimit të ankesës (përzgjidh njërin opsion) Postë <input type="checkbox"/> ZIN <input type="checkbox"/> Email <input type="checkbox"/>
Nr. i personal të identifikimit	Nr. cel: _____	Mënyra e marrjes së përgjigjes (përzgjidh njërin opsion) Postë <input type="checkbox"/> ZIN <input type="checkbox"/> Email <input type="checkbox"/>
Përshkrim i detajuar i çështjes për të cilën bëni ankesë:		
Listoni dokumentet që i bashkëlidhen kësaj ankesë:		
1. _____		
2. _____		
3. _____		
4. _____		
Çështja për të cilën bëni ankesë a është në proces gjygjësor: PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>		
Për çështjen për të cilën bëni ankesë a ka një vendim gjygjësor të formës së prerë: PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>		
A e keni dërguar më parë një ankesë të ngjashme pranë Bashkisë _____ : PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> , nëse PO, viti _____		

Shënime:

1. Ankesa e panëshkruar nuk do të pranohet për shqyrtim nga Bashkia.

2. Dërgimi i ankesës në mënyrë elektronike ose me postë kërkon bashkëlidhur një kopje të kartës së identitetit.

3. Të dhënat që përmban ankesa do të përpunohen në përputhje me Ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".



SHËRBIMET QË OFRON BASHKIA

Në fushën e
infrastrukturës

Në fushën e
mbrojtjes sociale

Në fushën e
sigurisë publike

Në fushën e
kulturës, sportit dhe
veprimtarive
argëtuese

Në fushën e
mbrojtjes së mjedisit

Në fushën e
zhvillimit ekonomik
vendor

Në fushën e
bujqësisë, zhvillimit
rural, pyjeve, dhe
kullotave

Në lidhje me
funksione të tjera të
deleguara

Shërbime publike në fushën e infrastrukturës

Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe **furnizimin me ujë të pijshëm**.

Mbledhjen, largimin dhe **trajtimin e ujërave të ndotura**.

Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe **mbrojtjen nga përmbytjet** në zonat e banuara.

Ndërtimin, rehabilitimin, dhe **mirëmbajtjen e rrugëve** vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Ndriçimin e mjediseve publike.

Transportin publik vendor.

Ndërtimin, rehabilitimin dhe **mirëmbajtjen e varrezave** publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.

Shërbime publike në fushën e infrastrukturës

Shërbimin e **dekorit** publik.

Parqet, lulishtet dhe **hapësirat e gjelbra** publike.

Mbledhjen, largimin dhe **trajtimin e mbetjeve** të ngurta dhe shtëpiake.

Ndërtimin, rehabilitimin dhe **mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore** të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Administrimin dhe rregullimin e **sistemit arsimor parashkollor** në kopshte dhe çerdhe.

Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe **kontrollin e territorit**, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Shërbime në fushën e mbrojtjes sociale

Krijimin dhe administrimin e **shërbimeve sociale**, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndërtimin dhe administrimin e banesave për **strehimin social**, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndërtimin dhe **administrimin e qendrave** për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të **fondit social** për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Shërbime në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave

Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së **ujitjes dhe kullimit**, të transferuar në pronësi të tyre.

Administrimin dhe **mbrojtjen e tokave** bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj.

Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të **informacionit dhe këshillimit** bujqësor e rural.

Administrimin e **fondit pyjor dhe kullosor** public.

Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit.

Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor

Hartimin e **planeve strategjike** të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.

Ngritjen dhe funksionimin e **tregjeve publike** dhe të rrjetit të tregtisë.

Mbështetjen për **zhvillimin e biznesit të vogël**, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.

Organizimin e **shërbimeve në mbështetje** të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.

Publikimin e broshurave **informative**, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.

Dhënien e granteve financiare për **mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël** e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor

Në fushën e sigurisë publike

Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Garantimin e **shërbimit të zjarrfikësve**, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për **zgjidhjen e konflikteve në komunitet**.

Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve të tjera argëtuese

Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e **vlerave e të trashëgimisë kulturore** me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Organizimin e **aktiviteteve kulturore** dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e **bibliotekave** e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.

Organizimin e **aktiviteteve sportive**, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit** nga ndotja.

Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen nga ndotja akustike.**

Zhvillimin e **aktiviteteve edukuese dhe promovuese**, në nivel vendor, të cilat lidhen me **mbrojtjen e mjedisit.**

Kushtet për ofrimin e shërbimeve publike

Shërbimet publike të ofruara nga Bashkia duhet të sigurojnë :

- ✓ **Akses** për të gjithë (mundësi reale për marrjen e shërbimit publik, në përputhje me hartën e shërbimeve për cdo Nj.A.);
- ✓ **Cilësi** shërbimi (shërbime që përmbushin standartet e miratuara);
- ✓ **Sasi** të mjaftueshme shërbimesh (shërbim i mjaftueshëm);
- ✓ **Kosto të përballueshme** për të gjithë (tarifa të diferencuara sipas mundësisë për cdo shtresë dhe kategori në nevojë).

Kushtet e mësipërmë janë të ndërvarura dhe të lidhura ngushtësisht me njëri- tjetrin.

Standardet e shërbimit publik

Standartet shërbejnë për:

- **Garantimin** e shërbimeve cilësore;
- Tregojnë **cfarë duam të arrijmë**;
- Shërben si **udhërrëfyes** për ofruesin e shërbimit;
- Tregojnë **cilësinë** dhe shërbejnë për krijimin e treguesve për matjen e tyre;
- Shërbejnë për **krahasim** të cilësisë së shërbimit;
- Ndhmojnë për kalimin **nga një nivel shërbimi tek një nivel më i lartë**.

Standartet e shërbimit publik

- ✓ Standarte kombëtare- standarte minimale
- ✓ Standarte vendore
 - ✓ Sasiore
 - ✓ Cilësore
 - ✓ Standarte me nivele (minimal, mesatar, i lartë)
 - ✓ Të matshëm
 - ✓ Të njohura për publikun e gjërë.

Treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit publik

Treguesit shërbejnë për matjen e:

- ✓ **Aksesit** për marrjen e shërbimit *sepse* - shërbimi duhet të jetë i aksesueshëm.
- ✓ **Shpejtësisë** së ofrimit të shërbimit *sepse* - shërbimi duhet të jetë i shpejtë.
- ✓ **Transparencës** së ofrimit të shërbimit *sepse* - shërbimi duhet të jetë transparent.
- ✓ **Efektivitetit** të shërbimit *sepse* - shërbimi duhet të jetë i efektshëm.

Në cdo rast, respektimi i barazisë gjinore duhet të jetë gjithashtu tregues i matshëm.